



NJOFTIM PËR SHTYP

Delegacioni i paraprirë nga Aco Ristov, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale (KRrE), në suaza të së cilit janë Ane Leshkoska, zëvendësministre e mjedisit jetësor, drejtorët e disa Ndërmarrjeve Publike Komunale, të Inspektoratit të Mjedisit Jetësor dhe të Shoqatës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit - ADKOM, do të qëndrojnë në vizitë pune në Republikën Popullore të Kinës.

Shkëmbimi i përvojave dhe njohja me teknologjitë bashkëkohore për menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave komunale, është qëllimi i vizitës së punës që realizohen nën organizimin e Institutit të Biogazit, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Punëve Rurale, në bashkëpunimi me ambasadën e Republikës Popullore të Kinës.

Në fokusin e vizitës është shkëmbimi i praktikave më të mira gjatë krijimit të proceseve për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të klasifikuara, si dhe për mundësitë për prodhimin e energjisë nga mbeturinat, zhvillimin e tyre dhe teknologjinë.

Në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore, KRrE-së iu dha autorizimi i zgjeruar dhe iu dha detyra për rregullimin e shërbimeve për menaxhimin me mbeturina komunale. Sjellja e Metodologjisë për Përlllogaritjen e Çmimit për Grumbullim, Transportim dhe Largim të Mbeturinave dhe Tariforin për Deponimin e Mbeturinave - janë pjesë e proceseve që duhet të realizohen në periudhën në vijim.

Rregullimi në menaxhimin me mbeturinat do të mundësojë cilësi më të mirë të shërbimeve për konsumatorët, ndërsa për operatorët do të thotë optimizim të kostove dhe monitorim rregullator të investimeve në proceset për menaxhimin me mbeturinat dhe modernizim të tyre me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit jetësor.

21.5.2026



ул. Македонија бр. 25, палата Лазар Поп-Трајков - 6^{тм} спрат • 1000 Скопје,
Република Северна Македонија
Централа 02 3233-580 • Факс: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

Rr. Maqedonia nr. 25, pallati L Lazar Pop-Trajkov – kati i 6 • 1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk